

PROCESVERBAL

Sot, më datë 27.05.2019, në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, u organizua takimi i iniciuar nga Kryetari i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë me Kryetarët e shoqatave të kineastëve. Në takim morën pjesë:

Z. Esat Ibro,

Z. Artan Maku,

Z. Ndriçim Xhepa,

Z. Dritan Huqi,

Znj. Sabina Kodra,

Z. Eno Milkani,

Z. Pluton Vasi,

Z. Jonid Jorgji.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë përfaqësohej nga:

Z. Eduart Makri, Kryetar

Z. Arben Lami, Drejtor i Drejtorisë së Projekteve

Znj. Shqiponja Dauti, Juriste.

Kryetari i QKK-së, shpjegoi arsyet e organizimit të këtij takimi konsultativ, duke parashtruar ndryshimet ligjore që ka iniciuar QKK, si dhe situatën e krijuar nga procedurat e miratimit të këtyre ndryshimeve ligjore. Duke qenë se këto ndryshime kërkojnë kohë të gjatë në dispozicion dhe kjo gjë vë në rrezik efikasitetin e përdorimit të buxhetit të QKK për fondet e projekteve kinematografike, është imediate nevoja e rikompozimit të formës dhe përzgjedhjes së Këshillave të Miratimit të Projekteve.

Kryetari propozoi që ndërmjet bashkëbiseduesve duhet të arrihet një marrëveshje me shkrim për të ngritur KMP sipas formulës që QKK ka parashikuar në projektligjin e përgatitur për ndryshim në ligjin nr.

8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë". Pas diskutimesh të shumta, pjesëmarrësit në takim ranë dakort:

1. Të zgjidhen Këshillat e Miratimit të Projekteve, në përbërje të të cilëve do të jenë anëtarë me shtetësi shqiptare dhe të huaj.
2. Të përcaktohen kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët për të qenë anëtarë të KMP-ve, të cilët do të zgjidhen me procedurë aplikimi të hapur. Kryetari i QKK do të përzgjedhë nga aplikantët një numër kandidatësh (dyfishin e anëtarëve të KMP që do të përcaktohen). Përbërja e KMP-ve do të përcaktohen nga shoqatat e kineastëve.
3. Formula e përbërjes së KMP-ve do të përcaktohet me konsensusin e palëve në takimin e rradhës.
4. Të ngrihen dy këshilla të miratimit të projekteve, këshilli për miratimin e projekteve të filmit artistik dhe dokumentar dhe këshilli për miratimin e projekteve të filmit të animuar.
5. Procesi i zgjedhjes së KMP-ve të përfundojë brenda datës 30 Qershor 2019.
6. Kryetarët e shoqatave të kineastëve do të jenë pjesëtarë të Këshillit Konsultativ të Kryetarit të QKK, për propozimet për ndryshimet ligjore.
7. Takimi i rradhës do të jetë në datën 30.05.2019.

Esat Ibro _____

Artan Maku _____

Ndriçim Xhepa _____

Dritan Huqi _____

Sabina Kodra _____

Eno Milkani _____

Pluton Vasi _____

Jonid Jorgji _____

Eduart Makri _____

Arben Lami _____

Shqiponja Dauti _____

Ky procesverbal nënshkruhet në 3 kopje origjinale.